



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 08

Prishtinë, më 30.01.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvie Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Doruntinë Maloku, Melihate Tërmkolli dhe Milena Miliqeviq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Margarita Kadriu, deputete; Lejla Selimi, OSBE; Ukë Gashi, ZPRK; Liridon Sadiku, IKPZH; Shefki Kastrati, NDI; Basri Berisha, Institucioni i Avokatit të Popullit; Naim Jakaj, GP-VV; Amire Qamili, BIRN; Valdet Hajdini, Instituti i Kosovës për Drejtësi; Ardian Bajraktari, MD; Burim Etemaj, Kuvendi i Kosovës; Dukagjin Maliqi, “Rrokum”.

Nga Stafi i Komisionit: Hana Bajraktari dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Diskutim rreth procedurave për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2015;
4. Shqyrtimi i propozimeve për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës;
5. Shqyrtimi i kërkesës së organizatës “Çohu”;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Diskutim rreth procedurave për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;

Kryetarja –Filloi mbledhjen dhe njoftoi anëtarët e Komisionit se si pikë e rendit të ditës është edhe diskutimi lidhur me procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, pra theksoi se prej muajit gusht, ky Këshill nuk është funksional, prandaj si Komision, ne duhet t'i përshpejtojmë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Në mbledhjen e fundit, ne kemi diskutuar gjithashtu se Këshilli na i ka propozuar një listë me 114 emra, mirëpo sipas Kushtetutës kjo është kompetencë e deputetëve, pra Këshilli nuk ka të drejtë të propozojë emra para anëtarëve të Komisionit për Legjislacion, përveç në ndonjë rrethanë tjetër, nëse kërkohet nga anëtarët e Komisionit. Gjithashtu, theksoi se edhe në mbledhjet e kaluara kam propozuar që zgjedhja të bëhet me konkurs publik, pra t'i propozohet Kryesisë së Kuvendit të hapet konkursi publik, pasi që në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nuk ceken se si janë procedurat e përzgjedhjes, përveç që është kompetencë e deputetëve. Në të kaluarën janë zgjedhur nga grupet parlamentare, prandaj unë konsideroj që Këshilli të jetë funksional dhe do të ishte mirë që zgjedhja të bëhet nëpërmes konkursit publik. Gjithashtu, propozoi se në zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, duhet të jetë një anëtar nga Oda e Avokatëve, pra të kërkojmë nga Oda e Avokatëve t'i propozojnë tre anëtarë, e jo vetëm një siç është propozuar.

Melihate Tërmkolli – Kemi diskutuar edhe në mbledhjet e kaluara dhe unë jam plotësisht dakord që të shkohet me konkurs publik, mirëpo derisa në Kushtetutë është se zgjedhjen e bëjnë deputetët e Kuvendit të Kosovës, atëherë ne nuk mund të shkojmë me konkurs publik, pa e ndërruar Kushtetutën. Pra, unë jam në pajtim që propozimi le të shkojë nga grupet parlamentare, sepse ne jemi pjesë e grupeve parlamentare dhe sido që të jetë, propozimet do të shkojnë nga grupet parlamentare, për momentin ky do të ishte propozimi më i mirë. Ajo gjithashtu theksoi se duhet që sa më shpejt të zgjidhet kjo çështje se Këshilli ka mbetur shumë keq, kanë mbetur procese pa përfunduar që lidhen me natyrën e Këshillit.

Kryetarja – Në Kushtetutën e Kosovës, gjithashtu dhe në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nuk specifikohen procedurat, mirëpo thuhet se deputetët zgjedhin, nuk thuhet se propozojnë, pra unë propozova vetëm për Odën e Avokatëve të kemi 3 (tre) kandidatë tjerë, ndërsa për anëtarë të tjerë të jetë me konkurs publik. Kjo nuk është mënyra më e mirë e zgjedhjes, por më mirë se të propozohen nga grupet parlamentare. Duke marrë parasysh që sistemi i drejtësisë është degraduar, bile të kemi mundësi mos ta degradojmë edhe më tepër.

Selvie Halimi – Kemi një skemë para vetes që e ka sjellë USAID –i se sa anëtarë duhet të ketë Këshilli Gjyqësor dhe si duhet të jenë. Mendoj se sido që të vendosim, si me konkurs publik, si nga grupet parlamentare, nëse mendohet se do të ketë ndikim, atëherë ndikimi s'do të mungojë. Pra, ne këtu po diskutojmë që ndikimi të jetë sa më pak në zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit

Gjyqësor dhe kudo në sistemin e drejtësisë. Duke u bazuar në plotësim-ndryshim të Ligjit për Këshillin Gjyqësor, në bazë të disa informacioneve, do të jetë që Kuvendi më mos të marrë pjesë në zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, mirëpo atëherë duhen ndryshime edhe në Kushtetutë. Pra, unë them që të përfundojmë sa më shpejt këtë proces, për arsye se cilëndo formë ta marrim, nuk e dimë a do të jemi të saktë në përzgjedhje dhe më tepër do ta vonojmë funksionalizimin e Këshillit, pra t'i zgjedhim personat që e meritojnë të jenë anëtarë të Këshillit. Propozoj që ose të shikohen emrat që janë sjellë nga Këshilli, ose të kërkojmë lista me emrat e të gjithë gjyqtarëve, dhe gjithashtu, edhe emra shtesë nga Oda e Avokatëve, t'i shijojmë së bashku dhe t'i zgjedhim për t'i dërguar ata emra në seancë. Ne duhet të vendosim sesi të shkojnë emrat në Kuvend, a me dy emra për secilin propozim apo vetëm me nga një.

Kryetarja –Theksoi se nuk është e pajtimit në plotësim-ndryshim të Ligjit për Këshillin Gjyqësor që t'i merren kompetencat e Kuvendit për zgjedhje. Në planin e punës për këtë vit e kemi këtë ligj dhe kur të vijë koha, atëherë do të diskutojmë.

Selvie Halimi –Theksoi se edhe nëse zgjedhja do të bëhet nga ndonjë komision, atëherë prapë procesi në fund do të vijë në Kuvend dhe unë mendoj që nuk i merren kompetencat.

Kryetarja – U tregoi anëtarëve të Komisionit se pasi që në mbledhjen e kaluar, z. Peci na tha që mandati i përfundon në vitin 2016 dhe unë e di që z. Enver Pecit dhe Valdete Dakës i përfundon në vitin 2015. Kam kërkuar në emër timin që të më sjellin shkresa lidhur me mandatin dhe deri të hënën kam kërkuar të m'i dërgojnë.

Nezir Çoçaj- Këshilli Gjyqësor na ka propozuar të përfshihen të gjitha rajonet e Kosovës, pra unë jam që të kemi nga gjitha të gjitha rajonet. Andaj e mbështes këtë propozim, ndërsa nga Oda e Avokatëve nëse parashihet të jetë një i propozuar, atëherë ata e kanë propozuar një dhe mos të bëjmë ne ndikim, dy apo tre, pra sado që të mundohemi ne t'i ikim ndikimit, asnjë anëtar i Këshillit nuk mund të zgjidhet pa u votuar nga deputetët në seancë. Pra, mos ta zgjasim, sepse sa më shumë që e zgjasim, e vështirësojmë punën dhe Këshilli mbetet jofunksional .

Kryetarja – Propozoi që procesi të jetë me konkurs publik, për arsye se do të ketë barazi dhe transparencë për të gjithë ata që emërohen si anëtar të Këshillit, pra u cek se Këshilli për gjashtë muaj nuk është funksional. Ne ta zgjedhim kandidatin që vjen nga Oda e Avokatëve, ndërsa për 4 anëtarët tjerë, të ketë konkurs publik .

Armend Zemaj – Të gjithë ne kemi dëshirë që sistemi i drejtësisë të jetë i pavarur, por ne duhet t'i përmbahemi Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi. Ideja për konkurs publik është ide e mirë, mirëpo kur futemi në procedura të konkursit, prapë duhet të jetë një komision që t'i përzgjedh dhe cilat do të jenë kriteret për përzgjedhje. Konkursi publik do ta ngritë transparencën jashtë, mirëpo prapë Komisioni do të zgjedh listën e ngushtë e cila do të shkojë në seancë. Gjithashtu

edhe propozimi i dytë që të kërkojmë emra shtesë, të përfshihet edhe barazia gjinore, përveç kësaj liste që e kemi këtu, gjithashtu edhe nga Oda e Avokatëve të ketë emra më shumë, pra të jemi më praktikë dhe të zgjedhim mënyrën sesi do t'i zgjedhim anëtarët e Këshillit. Unë kisha kërkuar nga ju t'i shikojmë CV-të, të bëjmë përzgjedhjen dhe ta përfundojmë më shpejt këtë proces. Faji nuk është i Kuvendit që nuk janë zgjedhur anëtarët, sepse ka edhe raste kur proceset lihen në momente të fundit. Pra, unë mendoj që duhet t'i kërkojmë këto lista dhe të ulemi të punojmë lidhur me këtë proces.

Agim Aliu – Kemi diskutuar shumë gjatë lidhur me këtë proces për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit shpreh keqardhje se pas pesëmbëdhjetë vitesh ne nuk kemi një mënyrë të saktë se si të përzgjidhen anëtarët e Këshillit. Përkrah cilëndo formë të përzgjedhjes, vetëm mos të biem ndesh me ligjet dhe Kushtetutën. Në mbledhjen e kaluar, ne kemi pasur në takim edhe z.Enver Pecin dhe kemi kërkuar që në këto lista mos të jenë persona që janë nën hetime apo në ndonjë proces ndëshkues disiplinor. Unë përkrah idenë që të ketë përfaqësim proporcional, kriterin gjeografik, mirëpo në ato kritere të përfshihet profesionalizmi .

Gjithashtu, theksoi se është i pajtimit të ketë kandidatë më shumë nga Oda e Avokatëve, mirëpo mos ta bllokojmë funksionalizimin e Këshillit, por të kryejmë sa më shpejt procesin.

Kryetarja –Theksoi se konkursi publik nuk bie ndesh me Kushtetutën e as me ligjet në fuqi. Çështja e dytë është se në këto lista janë propozuar persona me 2-3 vjet përvojë pune, prandaj unë propozoj të kemi procesin e konkursit publik.

Margarita Kadriu –Theksoi se të gjithë ishte dashur të pajtohemi në një pikë se, Këshilli Gjyqësor është organi më i lartë që e mbikëqyrë dhe administron sistemin Gjyqësor në Kosovë, pra aty duhet të jenë njerëz profesionistë, e jo njerëz që manipulohen, shantazhohen e që mbikëqyren nga partitë politike. Gjithashtu, theksoi se duhet të ndërpriten praktikatat e deritanishme të zgjedhjes. Po ashtu, nga Oda e Avokatëve të kërkojnë më shumë emra, sepse kemi shpesh raste të konfliktit të interesit, sepse të gjithë ata avokatë që kanë qenë anëtarë të KGJK-së, i kanë fituar lëndët në gjykata, pasi kanë qenë pjesë e KGJK -së. Pra, theksoi se jam për konkurs publik ku do të zgjedhën njerëzit më profesionistë, e me pak ndikime politike, pra ne jemi ata që vendosim për të mirën e Këshillit Gjyqësor.

Nezir Çoçaj –Theksoi se nuk është i pajtimit që nuk janë përfshirë profesionistë nga radhët e kandidatëve të propozuar, sepse shkruan qartë në njoftim nga ana e KGJK-së, se personat nën hetime nuk janë të përfshirë në listë.

Melihate Tërmkollli – Ne po mundohemi të kërkojmë një proces më të lehtë. Atë proces jemi ne që e vendosim, pra të kemi njerëz profesionistë, të pandikuar politikisht, nuk do të thotë që s' do të ketë ndikime politike, mirëpo që zgjedhja të jetë sa më profesionale, pra esenca e gjithë kësaj është se kë e propozojmë. Nuk jam e pajtimit për përfshirje territoriale, ndërsa sa i përket

konkursit publik është proces i mirë, mirëpo edhe aty kanë ardhur në fund persona që janë përkrahur nga grupet parlamentare, këto kanë qenë praktikat e mëhershme. Unë kisha dashur që anëtarët e Këshillit t'i zgjedhë Presidenti, jo Kuvendi, por për këtë duhet të ndërrohet Kushtetuta. Pra, kur jemi të përfshirja territoriale, unë pyeta z.Enver Peci se a është e përfshirë edhe Prishtina, ai u përgjigj se 5 anëtarë me mandat janë të Prishtinës, e sipas mendimit tim, asnjëri nga këta nuk janë. Pra, unë pajtohem për kritere profesionale, por jo edhe gjeografike. Normalisht, barazia gjinore duhet të respektohet e gjithashtu edhe kriteri për minoritete. Pajtohem që të kemi emra më tepër se kjo listë që e kemi, dhe gjithashtu, emra më shumë nga Oda e Avokatëve, pra sot të zgjedhim modelin se si t'i përzgjedhim këta kandidatë .

Danush Ademi –Theksoi se Kushtetuta e thotë që duhet të jenë dy të komunitetit pakicë, pra unë nuk i kam shikuar të gjitha CV-të, përveç një të komunitetit rom dhe ai nuk është i përfshirë në ndonjë proces të hetimit ose ndonjë masë disiplinore.

Kryetarja –Theksoi edhe njëherë se nëse kalon propozimi i dytë, edhe pse uroj të kalojë propozimi i parë, atëherë të kërkohet nga KGJK-ja të mos dërgojnë emra me persona që janë nën hetime apo me ndonjë masë disiplinore .

Agim Aliu – Propozoi që shtatë gjykatat themelore ta kenë nga një anëtar në Këshill, sepse do të ishte më profesionale që shtatë rajonet të përfaqësohen .

Armend Zemaj – Të shkojmë me propozime dhe sa më shpejt të përfundojmë këtë proces lidhur me përzgjedhjen, të vendosim kujt po i drejtohem, çka po kërkojmë dhe javën e ardhshme të ulemi dhe të përfundojmë zgjedhjen e anëtarëve të KGJK-së. Pra, jenë dy propozime, ai me konkurs publik dhe si i dytë, me emra shtesë nga të gjitha gjykatat. Duhet ta cek një fakt, pse po thirrmi shumë në kualifikime apo në dosje. Ne nuk jemi kompetentë ta dimë a janë nën hetime apo jo. Mos të humbim kohë, të zgjedhim mënyrën më të mirë, pra deri javën e ardhshme dhe të ulemi t'i seleksionojmë, i propozojmë dhe dërgohen emrat në seancë dhe atëherë seanca vendos se kush do të zgjidhet.

Melihate Tërmkolli –Theksoi edhe njëherë se duhet të vendosim sot se si do të jenë procedurat për përzgjedhje, nuk mund të lihet për javën e ardhshme. Po ashtu, duhet të specifikohet se në seancë a duhet për secilën pozitë të shkohet me nga një kandidat apo dy kandidatë për secilën pozitë.

Kryetarja – Propozoi prapë të shkohet me konkurs publik, përveç te Oda e Avokatëve, pra të na sjellin edhe tre emra shtesë, ndërsa për anëtarët tjerë, të shkohet me konkurs publik.

Armend Zemaj – Nëse pajtohem që të shkojmë me konkurs publik, atëherë arsyetimi ligjor le të mbetet te kryetarja.

Kryetarja –Theksoi se konkursi publik nuk bie ndesh as me Kushtetutën, e as me ligjet e aplikueshme. Pra, unë mbaj përgjegjësinë për arsyetimin ligjor.

Agim Ademaj – Është më mirë të kërkohet lista shitesë me emra, normalisht pa u përfshirë emra që u janë shqiptuar masa disiplinore apo janë përfshirë në ndonjë proces hetimor. Sa i përket konkursit publik, nuk e dimë, ndoshta kryetarja do të ishte mirë të na shpjegojë sesi do të rrjedhë procesi i konkursit. Ne vetëm e dimë se Këshilli është bllokuar dhe duhet sa më shpejt të zgjidhim këtë bllokadë dhe të vendosim sot sesi do ta zgjidhim këtë proces.

Kryetarja – Kemi praktika për zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, shpallet konkursi, formohet një komision, i përzgjedh e pastaj seanca vendos kush zgjidhet. Pra, ne sot vetëm do të vendosim sesi do të jenë procedurat, po që se vendosim me konkurs publik, atëherë bëhet një rregullore dhe komisioni që i përzgjedh përfaqësohet nga secili subjekt politik, apo nga një anëtar i Komisionit apo të formohet një grup punues që do ta draftojë një rregullore, ku do të precizohen saktë procedurat e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit.

Margarita Kadriu –Propozoi që mos u jepet mundësia e zgjedhjes personave që janë të angazhuar neper borde apo ne ndonjë vend tjetër, mirëpo mundësia ti ofrohet atyre që nuk kanë ndonjë obligim e që do të jënë me funksional.

Doruntinë Maloku –Theksoi se mbështet propozimin për konkurs publik dhe kërkoi që të hidhet në votim ky propozim.

Kryetarja – Hodhi në votim propozimin, që të shkohet me konkurs publik për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ku do t'i propozohet Kryesisë që t'i propozojë Kuvendit të hapet konkursi publik. Me 6 vota kundër, nuk kaloi propozimi i parë.

Propozimi i dytë ishte që të kërkohen lista me emra shitesë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe nga Oda e Avokatëve për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i cili me shumicë votash u përkrah nga anëtarët e Komisionit.

Kryetarja konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, nxori këtë

Përfundim

- I. Kërkohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që Komisionit t'ia dërgojë listën me emra të të gjithë gjyqtarëve në Republikën e Kosovës, së bashku me biografite të tyre, si dhe në lista të mos përfshihen gjyqtarë të cilët janë nën hetime ose nëse ndaj tyre është shqiptuar ndonjë masë disiplinore.

- II. Kërkohet nga Oda Avokatëve që përveç kandidatit të propozuar, t'i propozojë edhe dy emra shtesë për anëtarë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe në propozimet tuaja mos të përfshihen avokatë të cilët janë nën hetime ose nëse ndaj tyre është shqiptuar ndonjë masë disiplinore.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2015

Kryetarja – Ne sot duhet ta miratojmë planin e punës, pasi që është vendim i Kryesisë që të dorëzohet deri më 2 shkurt. Unë kam draftuar një plan dhe besoj që të gjithë e keni shikuar dhe kam përfshirë nga strategjia legislative ligjet dhe projektligjet që janë paraparë, mirëpo nuk kam përfshirë nga kjo strategji amendamentet kushtetuese, pasi që nuk janë precizuar se cilat amendamente. Edhe pse Komisioni i shqyrton të gjitha, por jo pa u cekur se cilat janë ato, mund të jenë për FAK-un, për Gjykatën speciale, për asociacionin e komunave etj, pra, nuk janë precizuar, andaj edhe nuk i kam përfshirë në plan. Po ashtu, nuk e kam përfshirë në plan as Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, sepse ky projektligj është në shpërpunje të plotë me Kushtetutën e Kosovës. Ky Projektligj i jep kompetenca speciale përfaqësuesit të Bashkimit Evropian, e që bie ndesh edhe me ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Selvie Halimi –Theksoi se plani është mjaft i ngarkuar, mirëpo kjo vjen si rrjedhojë e mos-funksionimit të institucioneve për gjashtë muaj, mirëpo ishte për miratimin e këtij plani të punës.

Armend Zemaj – Propozoi që Projektligji për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, të futet në plan të punës dhe kur të vijë koha, do ta shqyrtojmë se a bie ndesh me Kushtetutën. Nëse ne nuk e shqyrtojmë, atëherë mund të delegohet në ndonjë komision tjetër. Po ashtu, propozoi që në plan të përfshihet edhe Projektligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, si dhe në plan është mirë të përfshihen së paku dy ligje që të monitorohen se sa janë implementur.

Kryetarja –Theksoi se Projektligji për Agjencinë Kosovare për krahësim dhe verifikim të pronës, ndoshta nuk do të jetë në shqyrtim në komisionin tonë, do t'i takojë ndonjë komisioni tjetër, pra përderisa nuk e dimë se a do të jetë te ne si Komision, nuk mund ta kemi në plan të punës. Kurse lidhur me Projektligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, në mandatin e kaluar, ka mbetur pa u përfunduar, dhe në bazë të Rregullores së punës, procesi duhet të fillojë prej fillimit, pra lidhur me këtë projektligj .

Melihate Tërmkolli –Theksoi se e mbështet këtë plan të punës, propozoi që edhe projektligji për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, të futet në plan të punës, ngase secili do komision të jete i ngarkuar ai projektligj prape do të kalojë neper Komisionin për Legjislacion,

e njëjta vlen edhe për amendamentet Kushtetuese që të futen në plan të punës, atëherë ne vendosim a do t'i pranojmë apo jo, pasi që nuk janë të precizuara cilat janë ato amendamente. Ishte e mendimit se sot duhet ta miratojmë planin e punës, por duke lënë hapësirë edhe për çështje të tjera që do të vijnë ndërkohë .

Kryetarja –Edhe një herë theksoi se ky është vetëm draft që duhet të miratohet, në ndërkohë mund të hiqet diçka apo të shtohet, pra ne mund të shtojmë edhe propozimin e OSBE-së për mbikëqyrje buxhetore.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, nxori këtë

Përfundim

Miratohet Plan i punës së Komisionit për vitin 2015.

4. Shqyrtimi i propozimeve për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Kryetarja – Roli i Komisionit në këtë proces është vetëm formal, pra ne kemi emrat e dërguar nga institucionet përkatëse, sipas nenit 3.3 të Ligjit nr. 02/L-25 për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës. Propozimet janë të kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, të Shoqatës së Prokurorëve të Kosovës, të Shoqatës së Gjyqtarëve të Kosovës, si dhe të Odës së Avokatëve të Kosovës. Fakulteti Juridik dhe Shoqata e Juristëve, nuk ka propozuar kandidat, andaj ne po e procedojmë me këta kandidatë që i kemi, në mënyrë që të funksionalizohet edhe Instituti Gjyqësor, për faktin që edhe këta për disa muaj nuk janë funksionalë.

Meqë nuk kishe vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, nxori këtë

R e k o m a n d i m

Të emërohen anëtarë të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, kandidatët:

Avdi Dinaj dhe Nebojsha Boriçiq, anëtarë nga Gjykata Supreme e Kosovës;
Idain Ismaili, anëtar nga Shoqata e Prokurorëve të Kosovës;
Ymer Hoxha, anëtar nga Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës, dhe
Ramë Gashi, anëtar nga Oda Avokatëve të Kosovës.

5. Shqyrtimi i kërkesës së organizatës “Çohu”

Kryetarja – Kemi pranuar një shkresë nga Organizata “Çohu”, e cila kërkon nga Komisioni për Legjislacion që në përputhje me Ligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit, të kërkojnë

formularët për deklarimin e pasurisë për zyrtarët e kësaj Agjencie, pra duke e përfshirë edhe z. Hasan Pretenin. Gjithashtu, theksoi se kur të formohet grupi punues për mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion, do të merret me këta formularë.

Propozoi që të që kërkohen nga Agjencia formularët e deklarimit të pasurisë për vitin 2013 dhe 2014. Po ashtu, të kërkohet nga Agjencia, që publikimi i formularëve të pasurisë së zyrtarëve të lartë të Agjencisë në ueb-faqe të bëhet vetëm pasi të njëjtat të dorëzohen në Komisionin parlamentar dhe pasi të merret pëlqimi i Komisionit se çdo gjë është në rregull, atëherë në datën e paraparë me ligj, të publikohen në ueb faqen e Agjencisë.

Komisioni përkrahu propozimin e kryetares që të kërkohen nga Agjencia formularët e deklarimit të pasurisë për vitin 2013 dhe 2014.

6. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë, nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:05.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja Komisionit,
Albulena Haxhiu
